



**Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, dhe nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 21, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 06/L -092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 02.05.2019, merr këtë

V E N D I M

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01. NR. 046-295921, TË
DT. 06.12.2016, PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË
PALUAJTSHME KOMUNALE QENDRËS SË ARTEVE TË KOSOVËS**

I.

MIRATOHET Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës.

II.

Sipas vendimit të cekur në pikën I, plotësim-ndryshimi nënkupton:

1. Ndryshohet pika II e vendimit, hiqen parcelat kadastrale nr. 494 dhe 495, me sipërfaqe prej 2000 m², Zona kadastrale Nëntë Jugoviq, Prishtinë, dhe në vend të tyre shënohet parcela nr. P-71914021-00495-4.

III.

Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të cekur në pikën II, është bërë pasi që është lëshuar një gabim teknik, ku në vend të parcelës kadastrale nr. P-71914021-00495-4 ZK, janë shënuar parcelat nr. 494 dhe 495.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-0101046/19, më 03.05.2019**

**KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta**